VENDIM
Nr. 102, datë 19.2.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 784, DATË 18.12.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE AEROPORTUALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 784, datë 18.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Zona e mbrojtur e aeroportit, në kuptim të këtij vendimi, nënkupton zonat territoriale, që shtrihen sipas rrezeve përkatëse, të përcaktuara dhe të ndara më poshtë, në të cilat zbatohen rregulla të posaçme për zhvillimin apo ndërtimin e objekteve:

a) Zona "A" është zona e cila shtrihet në një rreze prej 2 (dy) kilometrash nga pika e referimit të aeroportit;

b) Zona "B" është zona e cila shtrihet në një rreze prej 2 (dy) kilometrash nga përfundimi i zonës "A";

c) Zona "C" është zona e cila shtrihet në një rreze prej 11 (njëmbëdhjetë) kilometrash nga përfundimi i zonës "B".".

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Leja për zhvillim apo ndërtim në zonën "A" merret pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim "KKTU"), sipas parashikimeve në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar.".

3. Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1 dhe 6/2, me këtë përmbajtje:

"6/1 Leja për zhvillim apo ndërtim në zonën "B" merret pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, sipas parashikimeve në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përveç rasteve dhe kërkesave për leje për objektet jo më shumë se 15 metra lartësi nga toka.

6/2 Në zonën "C", për objektet, që janë 30 metra lartësi nga toka ose më shumë, leja për zhvillim apo ndërtim merret pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, sipas parashikimeve në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.".

4. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. KKTU-ja dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit, për çdo objekt apo strukturë të planifikuar për ndërtim apo instalim në zonat e mbrojtura "A" dhe "B" të aeroportit, përpara dhënies së lejes duhet që të marrin miratimin nga AAC-ja. Në zonën "C", miratimi nga AAC-ja jepet vetëm për objektet që janë 30 metra lartësi nga toka ose më shumë, për të cilat leja jepet nga KKTU-ja, sipas pikës 6/2, të këtij vendimi. Miratimi i AAC-së jepet vetëm për zhvillimin apo ndërtimin e objekteve që sjellin pengesa për operimet ajrore.".

5. Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

"12/1. Hartat treguese për zonat e mbrojtura "A", "B" dhe "C" të aeroportit, sipas këtij vendimi, janë sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.".

6. Në pikën 13, në fund të fjalisë pas fjalëve "... pranë KKTU-së" shtohen "... ose njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve në këtë vendim.".

II. Shtesat dhe ndryshimet e bëra me këtë vendim i shtrijnë efektet që nga data 23.12.2024.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Shtojca I – Harta Treguese